



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 22 qershor 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mori pjesë si deputete e interesuar: Alma Lama

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Fitim Krasniqi dhe Zahri Bajrami – Zyra e Kryeministrit, Shqipe Krasniqi- Agjencia për Barazi Gjinore, Valdet Gjinovci – Agjencia e Veterinës dhe e Ushqimit, Ali Hamiti dhe Ejup Hasolli – ZRRE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 08.06.2011 dhe 15.06.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010.
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës Rregullatore për Energji, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010.
5. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 08.06.2011 dhe 15.06.2011,

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 08. 06. 2011, ndërsa miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 15 qershor 2011, shtyhet për mbledhjen e radhës meqenëse nuk është i përkthyer.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010.

Kryetari – Kërkoj sqarime rreth disa të gjeturave si: rekomandimet nga viti paraprak janë adresuar pjesërisht, të hyrat vetanake - a hyjnë këto të hyra në buxhet? Donacionet – nuk janë paraqitë me kohë. Pastaj, regjistrimi i pasurisë nuk është bërë në rregull, borxhi në veçanti rreth qirasë me INA, blerjet në tri raste janë blerë pajisje joadekuate në pajtim me atë që janë kontraktuar, prokurimi – kontrata joadekuate, gjatë prokurimit mungon procesverbali gjatë hapjes së tenderit- më vonë paraqiten parregullsi si pasojë e kësaj, ndryshon çmimi i faturës nga kontrata, dosjet e personelit kanë mangësi, kriteret rreth shpërndarjes së subvencioneve, borxhet ndaj personelit. Në raport thuhet se gjatë testimit të lëndës për angazhimin e konsulencës trajnerët ndërkombëtarë të agjencionit për barazi gjinore kanë parë që janë bërë pagesa në vlerë prej 1048euro secilit prej 2 trejnerëve të kontraktuar pas poseduar dokumentacionin përkatës pastaj data nuk përputhet, kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Fitim Krasniqi- Menaxhmenti i ZKM-së është pajtuar me të dhënat e ZAP-it dhe ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve. ZKM ka shumë njësi buxhetore që janë të pavarura të cilat kanë departamentet e buxhetit kryeshefat të cilët kanë pozitën e barazvlefshme me pozitën e sekretarit të ZKM-së, dhe në këtë sekretari i ZKM-së nuk mund të referoj. ZKM ka bërë planin veprimi. Qiraja- derdhet drektë në Buxhetin e Kosovës dhe sekretari i ZKM-së ka kërkuar disa herë që për këtë të jetë përgjegjëse Ministria e Financave. Sa i përket marrëveshjes- është fjala për marrëveshjen në mes të UNMIK-ut, KFOR-it nga një përfaqësues i INA-së si dhe në nivelin e vëzhguesit nga ish kryeministri i atëhershëm z.Agim Çeku. Qiraja paguhet, por ka vonesa- janë bërë vërejtje që qiraja të paguhet me rregull, por ZKM s'ka mundësi me shume se kaq. Për Rekomandimet e tjera ZKM ka marrë përsipër përmbushjen e tyre. Dosja e personelit – është bërë një lëshim rreth trajnimeve në ZKM. Në ZKM -në vazhdimësi formohen zyre dhe është e pamundur që në çdo kohë të kompletohen dosjet, por po bëhet çdo gjë që këto të evitohen. Subvencionet – me plan veprimi ZKM ka paraparë kategorizimin e subvencioneve, të specifikohen se në cilat nivele do të shkojmë për arsye se në ZKM ka kërkesa të ndryshme dhe është e pamundur që të planifikohen në fillim të vitit. Tani e tutje do të specifikohet qartë dhënia e subvencioneve.

Shqipe Krasniqi - Agjencioni për Barazi Gjinore si njësi e ZKM ka pasur dy vërejtje substanciale nga raporti i auditorit. Për pjesën e parë është fjala për një kontratë të lidhur në mes të agjencionit dhe UNIFEM-it e që ka vlerë 12000\$ një projekt i cili është dashtë të realizohet brenda vitit - projekt ky që ka shkuar përmes një konkursi të hapur për rekrutimin e trajnerëve. Ka qenë një lëshim teknik nuk ka qenë lëshim i qëllimshëm, por për çdo aktivitet të agjencionit donatori ka monitoruar aktivitetet, megjithatë agjensioni merr përgjegjësitë e tij lidhur me këto të gjetura. Lidhur me të gjeturën e dytë që ka të bëjë me nënshkrimin e kryeshefit ekzekutiv në emër të zyrtarit të prokurimit - kjo ka ndodhë për arsye se agjencioni në atë kohë nuk ka pas zyrtarë të prokurimit dhe ka qenë rruga e vetme që mos të ngecin pagesat. Trajnimi është mbajtur konform marrëveshjes që kemi pasur me donator.

Valdet Gjinovci – AUV ka pranuar raportin e auditorit dhe është pajtuar me të gjeturat që janë evidentuar. Sa i përket taksave dhe grumbullimit të taksave është punuar në atë rregullore. Të hyrat e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës. Regjistrimi i pasurisë – janë ndërmarrë masat dhe është bërë regjistrimi i pasurisë dhe janë ndërmarrë veprimet që kjo të mos përsëritet.

Pagesat që nuk janë në përputhje me çmimet e kontraktuara – fjala është për servisimin e automjeteve, realisht është fjala për automjete që kanë qenë donacion. Në të ardhmen kjo nuk do të përsëritet. Prokurimi pa kontrata – ndryshon çmimi i faturës nga kontrata, kjo e gjetur ekziston. Mungesa e dëshmive në procedurën e prokurimit – gjatë hapjes së ofertave komisionet nuk kanë pasur vendim të veçantë, por vetëm në formë elektrike, kjo çështje nuk do të përsëritet. Blerjet përmes prokurimit – pranimi i pajisjeve jo në përputhje me kontratë – pajisjet e pranuar disa janë më të avancuara, d.m.th. nuk janë ashtu siç janë specifikuar në kontratë. Auditor të brendshëm nuk kjo do të bëhet së shpejti.

Ramiz Lladrovci - Opinioni i pakualifikuar është vlerësimi më i mirë pozitiv për pasqyrat që bënë ZAP-i. Përgëzoi sekretarin për punën dhe tha se kjo duhet të jetë shembull për udhëheqësit e OB. Sa i përket agjensioneve në kuadër të ZKM-së duhet ta kemi parasysh se sekretari nuk udhëheqë me punën e këtyre agjensioneve. Të gjeturat rekomandoj që të zbatohen si dhe i inkurajoj për punë.

Murselj Haljilji – Pyeti: cilat janë ato katër raste ku nuk janë prezantuar argumentet e plota për mënyrën e përdorimit të subvencionet.

Valbona Dibra – Raporte e tilla duhet të merren shembull. Propozoi që meqnëse agjensionet janë të pavarura dhe sekretari i ZKM-së nuk ka ndikim në realizimin e buxhetit propozoi që auditimi i këtyre agjensioneve të bëhet ndaras.

Armend Zemaj – Pasi që kjo është qeveria e vetme në botë që s'ka Ligj dhe funksionimi i agjencive në kuadër të ZKM-së e ka komplikuar edhe mënyrën e raportimit. Kujt i raportojnë Agjencitë të cilat janë në kuadër të ZKM-së? Të gjeturat janë të papranueshme. Prokurimi në rastin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës mbetet i dyshimtë. Është e papranueshme që kryeshefi të nënshkruaj në vend të shefit të prokurimit. Mungesa e legjislacionit dhe mungesa e dhënies së përgjegjësisë ka ndikuar edhe në këto probleme. Auditimet për agjensionet e pavarura të jenë auditime të ndara nga auditimi i përgjithshëm. Subvencionet dhe transferet-keqpërdorimet më të mëdha bëhen për subvencioneve dhe transferove. Edhe ZAP-i duhet të fokusohet më shumë në këto situata. Problemi më i madh është mbikëqyrja e këtyre subvencioneve. Deri më tani s'kemi mbikëqyre të mirëfilltë as nga ZKM e as nga Ministri dhe në mbetet vetëm prej organet hetimore për rastet e caktuara kur dyshohet për keqpërdorime. Rekomandoj OB me zyre të veçanta të kenë auditim të veçantë. Nëse duhet të jenë në kuadër të ZKM-së atëherë duhet të jetë një hierarki përgjegjësisë. Opinioni është i pakualifikuar se nuk është fshehur asgjë por të gjeturat nuk mund të tejkalohen.

Alma Lama – Pyeti: si është kualifikuar opinioni i pakualifikuar nga ZAP-i kur ka kaq shumë shkelje? Shumë shqetësues ka të bëjë me prokurime dhe kjo po ndodh në ZKM, kjo është shumë negative sepse prej kësaj zyreje procesi i prokurimit duhet të vij frymëzimi pozitiv. Kjo është sidomos problematike në AUV blerja e aparaturave për analizën e ushqimit, kjo ndikon drejtpërdrejtë në jetën e qytetarë. Pse ka ndodhur kjo? Pikat sanitare të cilat kanë qenë në dogana ka largim të stafit profesional në atë shkallë dhe ka rekrutim të stafit të cilët nuk kanë të bëjnë me këtë punë.

Valbona Dibra – Ekzistojnë standardet ndërkombëtare të auditimit të cilat e përcaktojnë opinionin e auditorit.

Pyeti: aparatura në këtë laborator a është për këto produkte të dyshimta në kufi.

Muhamet Mustafa – Është diçka e mirë kur ZKM ka një opinion pozitiv nga ZAP-i. Duhet pasur parasysh faktin se ZKM përfshinë në vete shumë agjenci shumë staf prandaj disa nga agjensionet si AUV të kenë një auditim të veçantë.

Lars Lage OLOFSSON - Modeli që është zgjidhur për AUV nga ligjbërësit është se AUV është agjenson i pavarur por nën ZKM. Dhe ky agjenson është përgjegjës për ZKM-së.

Përgjegjësitë financiar të ZKM-së i mbulon edhe agjencionet e pavarura. Pra ZKM duhet të kërkojë llogari nga ata se si e kanë kryer punën. Por ka mundur të bëhet edhe zgjidhja tjetër d.m.th buxheti ti ndahet nga kuvendi dhe këto agjensione ti përgjigjen drejtpërdrejtë Kuvendit. Dhe menaxhimi financiar dhe korniza ligjore është mjaft e qartë.

Fitim Krasniqi – Agjencionet janë të pavarura dhe i përgjigjen drejtpërdrejtë kryeministrit. Pozicionet e kryeshefave janë të barasvlershme me pozitën e sekretarit d.m.th sekretari nuk mund të bëjë asnjë ndërhyrje në menaxhimin e tyre, sepse kjo përbënë konflikt interesi. Në ZKM ka me qindra procedura të prokurimit dhe nëse brenda viti ka një ose dy lëshime procedurale nuk mund të thuhet se është një shkelje e madhe.

Zahri Bajrami – Procedurat e dhënies së subvencioneve janë në rregull, katër rastet e përmendura janë katër OJQ prej të cilave tri janë të minoriteteve dhe tjetra është Hendikep. Qëndrimi i auditorit është që për to të hartohet një proces nëse OJQ-të dhe Hendikepi i ka shfrytëzuar këto subvencione ose jo.

Valdet Gjinovci – Pajisjet e laboratorit auditori ka konstatuar se janë pajisje të avancuara dhe në laborator nuk kryhen analiza të ushqimit. Për momentin ato aparatura nuk janë në funksion, janë pajisje matëse.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

- *Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*
- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në të ardhmen- për të gjitha agjencionet e pavarura duke përfshirë edhe agjencionet që janë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të bëjë një auditim të veçantë.*

Muhamet Mustafa – Propozoi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë një auditim të veçantë për Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinës për vitin 2010.

Kryetari konstatoi se me katër vota “për”, katër vota “kundër” dhe një “abstenim” nuk miratohet propozimi i deputetit Muhamet Mustafa.

4. Shqyrtimi i Raportit i auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës Rregullatore për Energji, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010

Kryetari – Opinioni është i pakualifikuar për këtë raport. Gjatë shqyrtimit auditori i ka vërejtur disa çështje. Problemet që paraqiten janë rreth prokurimit, pastaj sistemi për regjistrimin e të hyrave, regjistrimi i pasurisë në dy kode, Njësia e Auditimit të Brendshëm, kërkojë sqarim për këto të gjetura. Çështje tjetër rreth pagës - është ndarë në bazë dhe variabile. Pyeti: si është ajo dhe në çfarë baze është variabiliteti?

Ali Hamiti – Në ZRRE ka pasur pasaktësi teknike të udhëheqjes eventuale të ndonjë procedure. ZRRE është zyrë e pavarur e themeluar me ligj, ty hyrat që mbledh ZRRE në bazë të ligjit dhe udhëhiqen në llogari të veçantë në thesar. Te prokurimi, agjencioni nuk ka prokurim të madh dhe si agjencion i vogël shpeshherë ka pasur problem me ofertat e vogla që të siguroj 3 oferta është dashur të i përsëriten disa herë dhe ndonjëherë ka kushtuar më shumë publikimi në gazetë i tenderit se sa kushton vetë shërbimi. Sistemi për regjistrim të hyrave është një sistem se ZRRE praktikisht nuk ka llogari bankare, ka një nën-llogari në thesar. Të hollat që janë mbledhur gjatë këtij viti dhe nuk janë shpenzuar do të barten në vitin e ardhshëm.

Regjistrim të pasurisë – ZRRE është trashëguese e zyrës për shërbime publike që është quajtur PJUD dhe në atë kohë disa gjëra janë fal e disa janë blerë e disa janë regjistruar me emër të zyrës

e disa tjera në ndërkohë janë blerë. Janë regjistruar në dy kode:një kodë që është detyruar nga thesari dhe tani disa janë me një kod dhe tjerat që janë blerë.

Auditimi i brendshëm – ZRRE në bazë të ligjit, nuk parashihet të ketë auditim të brendshëm, megjithatë do të shikohen mundësitë për të aplikuar një zgjidhje.

Paga - bëhet vlerësimi çdo tre muaj është vlerësimi deri në 40% mundet me qenë zero, por edhe më shumë në bazë të rregullores, secili merr përqindjen janë 25 pikë që vlerësohet secili dhe në fund bëhet llogaritja dhe është një mënyrë e stimulimit në bazë të rezultateve të punës.

Lars Lage OLOFSSON - ZAP ka konstatuar disa lëshime të vogla në këtë organizatë dhe ZAP-i në vjeshtë do të përcjell se çka është bërë e çka s'është bërë.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni ishte dëshmitarë i dy raporteve me një opinion të pakualifikuar, që do të thotë se është opinionimi më i mirë i mundshëm i pasqyrave financiare. Përgëzoj ZRRE-në për punën e bërë. Ju bashkëngjit atyre shqetësimeve të vogla të kryetarit, dhe inkurajoj që buxhetin e pashfrytëzuar ZRRE të shfrytëzoj.

Valbona Dibra - Në bazë të raportit të auditorit ZRRE ka bërë një punë të mirë gjatë vitit 2010 dhe uroj që të vazhdojë ky trend gjithëherë. Meqenëse ZRRE nuk merr grante nga Qeveria e Kosovës, por realizojnë të hyra vetanake. Pyeti: sa është paga mesatare në ZRRE.

Ali Hamiti – ZRRE ka arritur që të marr konsulencë dhe ndihmë nga Banka Botërore dhe Komisioni European, pra këto organizata në periudha të caktuara kanë ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të zyrës. Paga mesatare është rreth 930 euro.

Armend Zemaj – Pyeti: këto mjete a ka arritur ZRRE t'i barazoj me thesarin ?

Ali Hamiti – ZRRE është barazuar me thesarin në mënyrë të plotë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Të ndryshme

a) Diskutim rreth rekomandimit të Komisionit për raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit për vitin 2010

Kryetari – Tha se rekomandimet e dy mbledhjeve të fundit të Komisionit duhet të finalizohen. Gjatë shqyrtimit Komisioni duhet të jetë i kujdesshëm në dhënien e rekomandimeve. Mendimi i komisionit ishte se ka nevojë për një auditim të performancës. Tani komisioni ka dy mundësi, të pres derisa të kryhet edhe auditimi i performancës, por refuzimi i raportit nuk vie në shprehje.

Vlbona Dibra – Komisioni në mbledhjen e kaluar ka dhënë rekomandimin që raporti të mos aprovohet derisa të bëhet auditimi i performancës së Fondit të Privatizimit. Sipas Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, nëse Kuvendi dhe Qeveria i bënë kërkesë me shkrim ZAP-it për auditim të një OB ZAP-i është i detyruar ta bëjë këtë. Komisioni po ashtu ka dhënë rekomandim se nëse mundësitë buxhetore të ZAP-it për angazhimin e ekspertit për këtë auditim janë të kufizuara atëherë mund të kërkojmë mbështetje nga KBF.

Lars Lage OLOFSSON – Obligimet kushtetuese janë që auditori të shkruaj raporte të cilat i dorëzon në Kuvend. Nuk është puna e këtij Komisioni që të aprovoj raportet e ZAP-it. Puna e Komisionit është që të shfrytëzoj këto raporte për të ndërmarrë masa. ZAP-i nuk do të kthehet në këtë raport, mundem bazuar në disa pyetje nga Kuvend, Qeveria apo dikush tjetër. Por

Komisioni nuk mund të vendos që të ndikoj në ZAP që të kryej auditim të performancë shtesë. Nëse Komisioni nuk është i kënaqur me punën atëherë Kushtetuta është e qartë se si të veprohet në këtë rast. Pra vendimet e Komisionit nuk mund të përzihet në punën e ZAP-it.

Valbona Dibra – Komisioni në asnjë mënyrë nuk tenton të ndërhyj në punën e ZAP-it. Përkundrazi jemi për të përforcuar këtë zyrë. Diskutimi sot ka të bëjë me atë se rekomandimi i marr në mbledhjen e kaluar po diskutohet sërish dhe kjo nuk është përfshirë si rekomandim në procesverbal.

Ramiz Lladrovci – Procesverbali nga mbledhja e kaluar nuk është përfunduar. Ky do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës. Po ashtu nuk duhet diskutuar rekomandimi nga mbledhja e kaluar, sepse komisioni ka marr vendim për një auditim të performancës. Kjo çështje është e mbyllur.

Alma Lama – Raportet e agjencive të ndryshme që i raportojnë Kuvendit duhet të shqyrtohen bashkë me raportin e auditimit të ZAP-it për këto agjencione. Është momenti që ky komision të dal me një rekomandim për Kuvendin që asnjë raport të mos shqyrtohet pa raportin e auditorit si dhe të bëhet ligj që të mos votohet për raportet e auditorit, por të votohet raporti i cili i përket agjencisë së caktuar.

Valbona Dibra – Shqyrtimi i dy raporteve në të njëjtën kohë në mbledhje plenare është i pamundur. Raporti i punës është i ndryshëm nga ai i ZAP-it. Raporti i punës së OB ku përfshihen edhe pasqyrat financiare e të cilat kanë të kufizuar afatin se kur dorëzohen ato nuk duhet të diskutohen në të njëjtën kohë, për faktin se OB në raportin e punës tregon objektivat e saj që ka arritur gjatë vitit, misionin, realizueshmërinë e buxhetit, ndërsa me raportin e auditorit vlerësohet se si ka punuar ajo organizatë.

Alma Lama – E rëndësishme është që shqyrtimi i punës së një institucioni të bëhet në mënyrë sa më të plotë, dhe raporti i auditorit është një ndihmë që deputetët të kenë një pasqyrë të qartë se çka po ndodhe. Ka praktika të mira që raportet harmonizohen dhe dorëzohen në një dokument.

Murselj Haljilji – Raportet duhet të shkojnë ndaras për shqyrtim sepse, auditimi ka qëllim tjetër.

Kryetari – Raportet e punës me ato që konstaton auditori janë krejtësisht të kundërta. Ka të gjetura që nuk përkojnë me raportin e punës. Edhe nëse nuk miratohen njëkohësisht, raporti i punës duhet të miratohet pasi që të jetë shqyrtuar raporti i auditimit. Lidhur me rekomandimin për fondin e privatizimit propozoi që komisioni të mos ndërmarrë asgjë derisa ZAP-i të bëjë auditimin e performancës.

Armend Zemaj – Me Ligjin për Themelin e ZAP-it, auditori i përgjithshëm i raporton Kuvendit dhe kjo pa qëllimin për të ndërhyrë në punën e ZAP-it. Komisioni është një trup në mes të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit. Komisioni ka nxjerr përfundimin se ka nevojë për një auditim të performancës. Se si do të gjendet zgjidhja këtë do ta bëjë Komisioni ose kryetari i komisionit që në bashkëpunim me KBF të gjejë një rekomandim për përkrahje buxhetore për një auditor të jashtëm për auditim të performancës së Fondit të Privatizimit. Përfundimi i mbledhjes së kaluar është përfundimtar dhe tani komisioni duhet të nxjerr një rekomandim lidhur me këtë.

Albert Kinolli - Komisioni po sillet në një rreth vicioz për diçka për të cilën është përfunduar. Pyeti: a ka përgjigje konkrete prej ndonjë institucioni ose organizate për të bërë auditimin e performancës? Deri tani Komisioni nuk ka bërë kërkesë lidhur me këtë dhe nuk ka marrë përgjigje as nga Qeveria e as ZAP-i, por po diskutohet për diçka që është e kryer.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur që ZAP-it t'i

REKOMANDOJ

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në bazë të nenit 3.7 të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr. 03/L-075, të bëjë një auditim të performancës së Fondit të Privatizimit.

b) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës

Valbona Dibra – Raportoj rreth aktiviteteve të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës. Grupi Punues ka mbajtur një mbledhje dhe ka realizuar dy vizita. Po ashtu Grupi Punues ka planifikuar takime me qëllim të shqyrtimit të informacioneve rreth zbatueshmërisë së Ligjit dhe Komisionit do t'i paraqes raportin përfundimtar për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu